# DËSHMI ARKIVI

**A-442628**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Yamal ngre zërin për Topin e Artë: Unë dhe Mbappe jemi më të mirët, çmimi më takon mua |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/yamal-ngre-zerin-per-topin-e-arte-une-dhe-mbappe-jemi-me-te-miret-cmimi-me-takon-mua/1010606/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 09:54:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 09:50:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e9f868adae0c3aa5a4c2ce311b8ff6ac3c6f13fba84dc86492dc7b11625f658a` |
| TEKSTI | `15f1727fdfcabb8a84769891a53fa703f02e0c01ca4409c3d1a5fac089a701ab` |
| PAMJA | `46e8ca5470fe63cf1b56302a1ecfda3517f5b2680733dcda623099e89d554362` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ba61842f42ec432ca27dc09ec40a54379fa2092f2bf4178c6cce891e62e3d870` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ba61842f42ec432ca27dc09ec40a54379fa2092f2bf4178c6cce891e62e3d870`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Yamal ngre zërin për Topin e Artë: Unë dhe Mbappe jemi më të mirët, çmimi më takon mua




Lamine Yamal ka hyrë hapur në garën për Topin e Artë, duke deklaruar se ai dhe Kylian Mbappe janë dy lojtarët më të mirë të futbollit botëror dhe se këtë vit trofeu duhet t'i jepet atij.

Ylli i Barcelonës e lidh këtë bindje me arritjet e sezonit të kaluar, gjatë të cilit fitoi Kupën e Botës me Kombëtaren e Spanjës dhe titullin e La Ligës me Barcelonën.

"Me sinqeritet besoj se janë dy prej nesh që jemi më të mirët në botë dhe këtë vit do ta meritoja për shkak të asaj që kam fituar", u shpreh Yamal në një intervistë për platformën spanjolle Movistar.

Ai shtoi: "Sa më përket mua, Mbappe dhe unë jemi dy më të mirët në botë. Për mua kjo është e qartë dhe këtë e di çdo person që i shikon ndeshjet".

Sezoni i 2025/26 ishte i jashtëzakonshëm për Yamal. Ai u zgjodh lojtari më i mirë i La Ligës dhe më pas pati një rol të rëndësishëm në suksesin e Spanjës në Kupën e Botës të zhvilluar në Amerikën e Veriut.

Mbappe, ndërkohë, shkëlqeu në planin individual. Sulmuesi francez doli golashënuesi më i mirë në Kupën e Botës, La Liga dhe Ligën e Kampionëve, por nuk arriti të fitojë asnjë trofe deri në përfundim të sezonit.

Një javë më parë, Mbappe kishte deklaruar gjithashtu se gjatë sezonit të kaluar nuk kishte pasur asnjë futbollist më të mirë se ai, duke sinjalizuar qartë synimin për të fituar Topin e Artë.

Megjithatë, vetëm pak ditë përpara kësaj deklarate, Yamal ishte treguar më i përmbajtur. Në një konferencë për media ai kishte thënë se, pas një sezoni "të jashtëzakonshëm", beson se mund ta fitojë çmimin, por nuk do të kërkonte vota.

19-vjeçari e mbylli edicionin e kaluar në vendin e dytë të renditjes për Topin e Artë, pas Ousmane Dembele. Mbappe ishte renditur i treti në vitin 2023, kur Lionel Messi e fitoi çmimin për herë të tetë.

të fundit/

Forumi Rinor i BDI-së proteston dhe kërkon largimin e ministrit…

Nagip Krasniqi mohon sërish akuzën për keqpërdorim të detyr…

Minçev: Kuadri i ri ligjor për pagat publike pritet të përfundojë deri në…

Zbulohet paneli i gjyqtarëve që do të shpallë vendimin për…

Xherdan Shaqiri shpërthen ndaj Luzernit dhe përfshihet në…

SHBA paralajmëron për tubime masive në Kosovë në prag të…

Bojkoti i avokatëve shtyn për dy javë gjyqin e dosjes "Partizani"

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Dembele mendon se trofeu duhet të qëndrojë sërish te një lojtar i Paris Saint-Germainit, pasi klubi francez ka mbrojtur titullin e Ligës së Kampionëve.

Mes kandidatëve të konsideruar favoritë për këtë çmim është edhe Harry Kane, sulmuesi i Bayern Munichut dhe i Kombëtares së Anglisë.

Fituesi i Topit të Artë për vitin 2026 do të bëhet i ditur më 26 tetor në Londër.

Shtuar më 14.09.2026 11:50

Tags: Kylian Mbappe , lamine yamal , Topi i Artë



Xherdan Shaqiri shpërthen ndaj Luzernit dhe përfshihet në formacionin ideal të…



Dopieta e Shpendit në Serinë B, Asani dhe Tuci gjithashtu protagonistë n…



Superliga e Kosovës vazhdon me dy përballje mjaft interesante




T'i bjerë kokës", plas kritikat ndaj Florin Bratut te Partizani: S'mund të bëjë…



Mourinho e ka vendosur, kjo pritet të jetë mbrojtja ndaj Atletico Madridit



Dy gola me Juventusin, por Edon Zhegrova mbetet jashtë Kosovës nga Fran…



Fabrizio Romano tregon prapaskenat: Spalletti shqyrtoi mundësinë ta…



Barcelona gati të sakrifikojë fituesin e Kupës së Botës për të transferuar Julian…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.